



AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“NEON ENERGY” sh.

Fier më datë 06/04/2022

NENI 1

Shoqëria Tregtare “NEON ENERGY” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “NEON ENERGY” sh.p.k

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë.

Konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë;
2. Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
3. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
4. Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import- eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
5. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj;



6. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme;

7. Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj;

8. Mirëmbajtja e centraleve energjitike;

9. Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresë: Lagjia "Apollonia" ,sheshi Nene Tereza ish-hotel "Apollonia" ,Fier.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 lekë. Kapitali ndahet në 4 (Kater) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

- z. Albert Malaj lindur më 29/11/1977 në Vlore, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr. H71129021C, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 25 % të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë 25.000 Lekë.
- z. Kreshnik Morina, lindur më 07/01/1988 në Fier, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet Pasaportes me nr. BJ7671568, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 25 % të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë 25.000 Lekë.
- z. Eraldi Qirio, lindur më 02/12/1982 në Korçe, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr. I21202053C, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 10 % të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë 10.000 Lekë.



• z.Vilçens Gremi me atesi Avni dhe amesi Hurma i datelindjes 26/10/1982 lindur ne Kolonje,Lushnje dhe banues ne Tirane mbajtes i kartes se identitetit me nr personal I21026012E ne cilesine e Adminbistratorit dhe ortakut themelues i cili zoteron 40% te vleres se kapitalit themeltare e barabarte me nje kuote 40000 leke

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.


Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është z Vilçens Gremi me atesi Avni dhe amesi Hurma i datelindjes 26/10/1982 lindur ne Kolonje,Lushnje dhe banues ne Tirane mbajtes i kartes se identitetit me nr personal I21026012Ene cilesine e Adminbistratorit Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administatori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqrisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit për atës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12


Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13

Dispozitat përfundimtare


Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Albert Meçaj


Eraldi Qirio


Vilçens Grëni


4

Skënder Moçino


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
NOTER ARTA L. SINO

DATE 06/04/2022

NR REP 544



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, para meje Notere ARTA L. SINO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, 29 NENTORI, KASTRIOT MUÇO, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Albert Malaj, atësia Bashkim, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në FIER, me adresë Nuredin Aliu 01490240; Nd. 3; H. 6; Ap. 5; Fier; Fier; 9303; Fier, lindur më 29/11/1977, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036015927 dhe nr. personal H71129021C , .

NËNSHKRUES/IT:

Kreshnik Morina, atësia Kujtim, amësia Shekrie, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në FIER, me adresë Mujo Ulqinaku 01490213; Nd. 62; H. 1; Ap. 2; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 07/01/1988, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037437872 dhe nr. personal I80107060E , .

NËNSHKRUES/IT:

Eraldi Qirio, atësia Maksim, amësia Ivoni, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në FIER, me adresë Lami Monka 01490158; Nd. 11; H. 16; Ap. 1; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 02/12/1982, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036502778 dhe nr. personal I21202053S , .

NËNSHKRUES/IT:

Vilçens Grëmi, atësia Avni, amësia Hurma, shtetas Shqiptar, lindur në Kolonjë, Lushnje dhe banues në Tiranë, me adresë Njesia Nr 7 Rruga 'stavri Themeli'; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 26/10/1982, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033032792 dhe nr. personal I21026012E , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “Akt Themelimi te shoqërisë "Neon Energy"shpk bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



V2022063110032485133

NOTER

ARTA L. SINO

Arta L. Sino